



VENDIM PËR PAPANUESHMËRI

Data e miratimit: 23 nëntor 2011

Numri i lëndës 2011-24

Z. Predrag Lazic

Kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 23 nëntor 2011, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Antonio BALSAMO, kryesues
Znj. Magda MIERZEWSKA, anëtare
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare

Asistuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Leena LEIKAS, zyrtare ligjore
Znj. Stephanie SELG, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa ishte regjistruar më 8 prill 2011.
2. Ankesa ka të bëjë me procedurat para Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës që kanë të bëjnë me çështjet e Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (më tutje si: DhVGJS). Znj. Bednarek është Anëtare e Panelit dhe gjithashtu gjykatëse e EULEX-it që shërben në DhVGJS. Prandaj, Znj. Bednarek nuk mund të merr pjesë në shqyrtimin e këtij rasti si anëtare e Panelit Ajo është zëvendësuar nga znj. Micheva-Ruseva, anëtare zëvendësuese.

II. FAKTET

3. Faktet e rastit, siç janë paraqitur nga parashtruesi i ankesës, dhe siç shihen prej dokumenteve në dispozicion të Panelit, mund të përmbliidhen si në vijim.

Parathënie

4. Ankesa ka të bëjë me një kontest rreth të drejtave pronësore në Komunën e Prishtinës. Parashtruesi i ankesës dhe katër persona të tjerë janë bashkëpronarë të tokës në fjalë.

Shpronësimi dhe vendimi për kthimin e tokës

5. Në vitin 1953 Komisioni i Qarkut për Fondin e Tokës Bujqësore, sipas Rezolutës nr. 62/53, kishte shpronësuar diku 2.85 hektarë të tokës së pronarëve për të mirën e fondit bujqësor si pronë e përgjithshme kombëtare.
6. Më 31 tetor 1991, parashtruesi i ankesës dhe katër pronarët e tjerë kishin paraqitur një kërkesë për kthim në Komisionin e Prishtinës për Kthimin e Tokës ("Komisioni"), bazuar në Ligjin për Kthimin e Tokës të marsit 1991. Pjesa kryesore e tokës në fjalë ishte regjistruar si pronë shoqërore (PSh) që të shfrytëzohej nga "Kosova Ekspert".
7. Më 4 tetor 1992, Komisioni kishte miratuar kërkesën dhe kishte urdhëruar "Kosova Export-in" për t'iu dorëzuar tokën në pronësi të tyre pas hyrjes në fuqi të vendimit. Palët kishin arritur një marrëveshje lidhur me kthimin e ngastrave të tjera të tokës.

Procedurat para Gjykatës Komunale dhe DhVGjS

8. Në një datë të panjohur, z. D.A. kishte parashtruar kërkesë për kompensim të dëmit kundër Kooperativës Bujqësore Llapna Sellë dhe të tjerëve në Gjykatën Komunale të Prishtinës, lidhur me ngastrat në pronësi të parashtruesit të ankesës dhe të katër personave të tjerë. Z. D.A. gjithashtu pretendonte pronësinë e këtyre ngastrave. Parashtruesi i ankesës dhe katër pronarët e tjerë nuk ishin palë në këto procedura.
9. Më 16 korrik 2010, Gjykata Komunale kishte dhënë një masë të përkohshme për z. D.A. lidhur me tokën në fjalë. Ky vendim në mënyrë efektive ka penguar kthimin e tokës së parashtruesit të ankesës ashtu siç përcaktohet në vendimin e vitit 1992 (shih paragrafin 7 më lart).
10. Pasi që ka mësuar rreth masës së përkohshme, parashtruesi i ankesës me datën 7 shtator 2011 ka kërkuar nga DhVGjS që të shfuqizoj vendimin e Gjykatës Komunale dhe masën e përkohshme. Procedurat mbeten të pazgjidhura.

Procedurat para Agjencisë Kadastrale të Kosovës

11. Më 11 tetor 2007, parashtruesi i ankesës dhe të katër pronarët e tjerë kishin kërkuar regjistrimin e pronësisë së tokës në fjalë tek Agjencia Kadastrale të Kosovës.
12. Më 23 maj 2011, parashtruesi i ankesës ishte njoftuar rreth pezullimit e përkohshëm të procedurave të regjistrimit para Agjencisë Kadastrale të Kosovës. Gjithashtu ai ishte kërkuar që të ofroj brenda pesë ditëve, dëshmi se masa e përkohshme e datës 16 korrik 2010 ishte hequr nga Gjykata e Qarkut të Prishtinës.
13. Parashtruesi i ankesës ka njoftuar Agjencinë Kadastrale brenda afatit kohor të caktuar se procedura civile para DhVGjS ishte në pritje, dhe se parashtruesi i ankesës dhe të katër pronarët e tjerë të tokës në këtë procedurë ishin të përfshirë vetëm tërthorazi. Më vonë ata parashtruan një kërkesë për të shfuqizuar masën e përkohshme (shih paragrafin 10 më lart).
14. Masa e përkohshme që ishte urdhëruar në lidhje me ngastrat e tokës në fjalë ishte hequr, në mënyrë që parashtruesi i ankesës ta regjistronte pronën e tij. Vetëm atëherë Agjencia Kadastrale do të vazhdoj të bëj regjistrimin. Duket se procedurat para Agjencisë Kadastrale janë ende në pritje.

III. ANKESAT

15. Parashtruesi i ankesës kërkon se Paneli të përshpejtoj procedurat para DhVGjS, që të siguroj se prona e tij të jetë e përjashtuar nga procedura civile para DhVGjS në mënyrë që ta regjistroj atë në Zyrën Kadastrale në Prishtinë.

IV. LIGJI

16. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullën 29 të Rregullores së Punës.
17. Paneli mund të shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në drejtës, polici dhe dogana, siç përcaktohen në Rregullën 25, paragrafi 1 i Rregullores së vet të Punës.
18. Sipas Rregullës të përmendur më lart, bazuar në konceptin e llogaridhënies në PLANIN OPERATIV të EULEX-it në Kosovë, Paneli nuk mund të shqyrtoj procedurat ligjore që janë para gjykatave të Kosovës. Në veçanti, nuk është funksion i tij që të merret me gabimet

e faktit apo ligjit që supozohet të jenë kryer nga gjykatat vendore, përveçse apo në atë masë sa do të kishin shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga ligji ndërkombëtar i të drejtave të njeriut i zbatueshëm në Kosovë.

19. Paneli konstaton se parashtruesi i ankesës ka kërkuar në fakt që Paneli të merr masa në mënyrë që të përshpejtoj procedurat në një rast të pazgjidhur pranë DhVGjS (institucion i Kosovës).
20. Paneli nuk ka kompetencë as në fushën administrative e as në fushën juridike të punës së gjykatave të Kosovës Fakti se gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues që janë të caktuar për ta shqyrtuar rastin nuk do të thotë se ia humb gjykatave karakterin e tyre si pjesë e sistemit juridik të Kosovës. Si pasojë, Paneli nuk mund të ketë ndikim në renditjen dhe mënyrën e shpejtësisë së shqyrtimit të ankesave të pazgjidhura që kryhen nga ana e DhVGjS.
21. Si pasojë, çështja që ngritët në këtë ankesë nuk bie brenda mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë, siç janë të përcaktuar në Rregulloren 25 të Rregullores së Punës dhe OPLAN-it të EULEX-it në Kosovë.

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI

konstaton se nuk ka kompetencë për të shqyrtuar ankesën,

gjen se ankesa është e pabazuar sipas Nenit 29 (d) të Rregullores së vet të Punës, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Antonio BALSAMO
Kryesues i Panelit